

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Në vlerësimet më të fundit, të kryera respektivisht në muajt korrik e gusht të vitit 2022, agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit të kredibilitetit Standard & Poor's dhe Moody's konfirmuan vlerësimin aktual të vendit tonë me "B+" dhe "B1", dhe me perspektivë të qëndrueshme. Ato kanë paraqitur qëndrueshmëri, pritshmëritë për vijimësinë e rritjes ekonomike dhe reduktimin e borxhit publik. Gjithashtu, hapja e negociatave të anëtarësimit në BE është një proces mjaft pozitiv për vendin tonë, sepse do të nxisë zbatimin e reformave, fuqizimin institucional të vendit, përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe rritjen e investimeve të huaja direkte.

Ndryshimi i parë në buxhetin e vitit 2022 është bërë me aktin normativ nr. 3, të datës 12.3.2022, i cili synonte akordimin e mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë elektrike dhe financimin e paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës. Ky akt normativ ruajti të pandryshuar treguesit kryesorë makroekonomikë, si deficitin buxhetor dhe borxhin publik. Ai rriti të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, respektivisht me shumën 10 miliardë lekë. Një nga ndryshimet kryesore të këtij akti normativ ishte financimi për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, në vlerën 6 miliardë lekë, e cila shkoi për të siguruar mbështetjen e shtresave në nevojë, sektorin e transportit publik dhe sektorin të bujqësisë.

Ndryshimet e propozuara me aktin normativ që po shqyrtojmë sot, do të shërbejnë për ruajtjen e parametrave kyç makrofiskalë, mbështetjen e shtresave më vulnerabël dhe të politikave prioritare të vendit. Gjithashtu, ky akt normativ parashikoi disa rialokime në shpenzimet korrente e kapitale, për të rritur efektivitetin e tyre. Ndryshimi i paraqitur me këtë akt normativ, është ndryshimi i dytë në buxhetin e vitit 2022, dhe qëllimi i tij është që, nëpërmjet

disa ndryshimeve dhe shtesave në buxhetin e vitit 2022, të mundësojë financimin e shtesave të popullsisë dhe të sektorëve të ekonomisë, që kanë pasur impakt më të madh nga situata e krizës, si dhe të reduktojë deficitin buxhetor e borxhin publik, për të siguruar qëndrueshmërinë e parametrave makroekonomikë të vendit.

Së pari, ky akt synon shtrirjen e financimit të paketës së parë të ndihmës për konsumatorët, të akorduar përmes aktit normativ të mëparshëm, me qëllim përballimin e mëtejshëm të pasojave të rritjes së çmimeve të konsumit. Kjo do të realizohet nëpërmjet alokimit të një fondi tjetër kontigjence për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj pasojave të krizës, me kosto 6,1 miliardë lekë për buxhetin e shtetit. Së dyti, kjo do të reflektohet po ashtu edhe në kahun e të ardhurave, me rritje në masën 30 miliardë lekë. Kjo rritje bazohet në performancën pozitive të realizimit të planit të të ardhurave tatimore e doganore nga administrata fiskale gjatë periudhës janar-korrik 2022, si dhe vlerësimi për ecurinë pozitive të të ardhurave deri në fund të vitit 2022.

Gjithashtu, këtu është reflektuar dhe ndikimi në tatime të çmimeve të rritura të mallrave dhe shërbimeve, si dhe rritja e pritshme e qarkullimit nga sektorët e turizmit, ndërtimit dhe shërbimeve të tjera si këto. Rritja e të ardhurave parashikohet në këto zëra, që janë: të ardhurat nga tatimet dhe doganat, nga TVSH, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat, taksat nacionale, taksat doganore, në masën 25 miliardë lekë; të ardhurat nga fondet speciale, që janë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat do të rriten në masën 5,6 miliardë lekë. Gjithashtu, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit rriten me 13 miliardë lekë. Janë parashikuar disa shtesa për politikat e vlerësuara si prioritare, dhe disa rialokime nga zërat që kanë pasur mosrealizim, drejt atyre që kanë arritur rezultate pozitive për periudhën gjashtëmujore.

Rialokimet kanë si qëllim rritjen e efektivitetit të shpenzimeve buxhetore dhe parashikohen të ndahen në këto zëra: 6,1 miliardë lekë do të shkojnë për zgjatjen në kohë të mbështetjes nëpërmjet paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, në formën e një fondi kontigjence; 1,67 miliardë lekë janë parashikuar për përballimin e efekteve eventuale të aktit normativ nr.10, të majit të viti 2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi” si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”; 4 miliardë lekë rritje

të shpenzimeve kapitale me financim të huaj, me qëllim risistemimin e fondeve të pakësuara përmes aktit të mëparshëm normativ, në programet “Transporti rrugor”, si dhe “Furnizimi me ujë dhe kanalizimet”; 1,72 miliardë lekë do të shkojnë për subvencionimin e qirasë për familjet e prekura nga tërmeti; 1,2 miliardë lekë për blerjen e teksteve shkollore falas dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit e nxënësit.

Si rrjedhim, do të bëhen edhe disa rialokime në shpenzimet buxhetore, ku do të shkurtohen 5,1 miliardë lekë, referuar zërave që kanë shënuar mosrealizim gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2022. Janë rreth 2,9 miliardë lekë, që janë reduktime në shpenzimet korrente, bazuar në vlerësimin e fondeve të lira në shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative e mirëmbajtjeje. Rreth 2 miliardë lekë janë shkurtime të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, si projektet infrastrukturore ende të paprokuruara, projekte të konsideruara si fonde të ngrira apo projekte që kanë pasur ecuri të dobët financiare, bazuar në vlerësimin e gjashtëmuajorit. Shpenzimet vendore do të reduktohen në masën 58 milionë lekë, që janë shpenzimet për financimin e huaj vendor, për shkak të mosrealizimit të plotë deri në këtë periudhë, dhe do të shtohen në masën 48 milionë lekë shpenzimet për transfertën e pakushtëzuar, pra për arsimin parashkollor 38 milionë lekë, ndërsa për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi 10 milionë lekë.

Do të shtohen gjithashtu me 10 milionë lekë shpenzimet për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për mbulimin e shpenzimeve të veprimtarive e funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat nuk kanë realizuar nivelin e të ardhurave gjatë gjashtëmuajorit. Ky akt normativ ka si qëllim prioritar financimin për vijimin e mbështetjes ndaj shtresave në nevojë dhe sektorëve të ekonomisë më të prekur nga kriza e rritjes së çmimeve. Gjithashtu, ai parashikon masa për rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike si dhe reduktimin e deficitit e të borxhit publik, duke respektuar rregullat fiskale të parashikuara në ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë ekonomike të vendit.

Prandaj, ftoj kolegët deputetë ta miratojmë. Po ashtu, paketa e rezistencës sociale e prezantuar sot nga Kryeministri dhe Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes afatmesme dhe të

qëndrueshme për përballimin e pasojave të krizës globale, do të jetë një ndihmë brenda kuadrit të ndihmës tonë buxhetore dhe mundësive që ka shteti shqiptar për t'i ndihmuar qytetarët e tij. Faleminderit!